

**AKT - THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“HYGEIA HOSPITAL - TIRANA” SH.A.**



Sot më datën 25 Prill 2007, aksionaret:

**1- Qendra diagnostikuese dhe terapeutike Athens Hygeia Sh.a (DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC CENTER OF ATHENS HYGEIA SA), me numer regjistrimi N.13165/06/B/86/14, me seli ne Bulevardi Kifisias & Erithru Stavru 4, 15123 Marusi, Athine, Gereqi, perfaqesuar nepermjet autorizimit te Bordit te Drejtoreve te dates 23.03.2007, Z. Themistoklis Charamis i biri i Vasilit, mbajtes i pasaportes me N. AB2499693**

**2- Z. Shyqeri Duraku, shtetas shqiptar, banues ne Tirane, Rruga Kavajes N.56, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes me N. D0000993.**

me vullnetin e tyre të lirë dhe në bazë të Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar” kanë rënë dakort për sa më poshtë vijon:

**Neni 1**

Palët pjesëmarrëse që nënshkruajnë këtë kontratë ranë dakort për krijimin e një Shoqërie, në bazë të këtij Akt - Themelimi si dhe Statutit bashkangjitur, duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar.

**Neni 2**

Emri i Shoqërisë do të jetë “HYGEIA HOSPITAL – TIRANA Sh.A” dhe në vazhdim do të referohet si “Shoqëria”.

**Neni 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Objekt i veprimtarisë së Shoqërisë do të jenë këto aktivitete:

1. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese, dhe, qendrave ambulatorë të diagnostikimit, në territorin e Shqipërisë.
2. Drejtimi i strukturave me qëllim promovimin e kërkimit mjekësor dhe metodat e diagnostikimit dhe kurimit.
3. Organizimi dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorë të kujdesit si konsulent.
4. Organizimi i qendrave të trainimit dhe/ose programeve për edukimin dhe trainimin e doktorëve, infermiereve, dhe personelit administrativ.

+

5. Zhvillimin e aktivitetit tregtar për importimin dhe/ose eksportimin e mjeteve mjekësore, aparatura dhe paisje, mjeteve farmaceutike, etj.
6. Organizimi i shërbimeve logjistike për materialet (e qëndrueshme dhe delikate) dhe lëndët farmaceutike të përdorura në strukturat e diagnostikimit dhe kurimit dhe qendrat ambulatorore të kujdesit.
7. Dhënia organizatave të tjera, i shërbimit të konsulencës lidhur me të gjitha aspektet e menaxhimit të kujdesit shëndetësor dhe shërbimit të kujdesit ndaj pacientit.

Përndjekjen dhe arritjen e objektivave të saj, Shoqëria do të:

1. bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo shoqëri tjetër me të njëjtin objekt, që kanë të njëjtat objektiva brenda Shqipërisë ose jashtë saj.
2. çelë degë, filiale, agjenci, ose zyra përfaqësimi Brenda ose jashtë Shqipërisë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. përfaqësojë subjekte ligjore dhe individë, shqiptarë ose të huaj, që kanë objekt të njëjë ose që lidhet me të.

#### Neni 4

Vendi i ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë dhe selia e saj ligjore ndodhen në Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Tirane, Shqipëri. Me vendim të Këshillit Mbikqyrës, Shoqëria mund të çelë zyra dhe agjenci si në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj, pas marrjes së miratimit nga shoqëria e regjistruar në Shqipëri.

Selia e shoqërisë si dhe adresa e saj ligjore do të jetë në autostradën Durrës - Tiranë.

#### Neni 5


Kohëzgjatja e Shoqërisë përcaktohet në bazë të këtij statuti në 50 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Gjykatë. Shoqëria mund të prishet edhe para se të mbarojë periudha 50 vjeçare ose kohëzgjatja e saj mund të zgjatet mbi 50 vjet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në bazë të legjislacionit shqiptar.

#### Neni 6

##### **KAPITALI**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë përcaktohet në shumën 126.000.000 lekë (njqind e njezete e gjashte milion lekë).
2. Kapitali ndahet në 126.000 (njqind e njezete e gjashte mije) aksione me vlerë nominale 1000 lekë (njemije mijë lekë) secila. Aksionet janë të pandashme.
3. Aksioneret bien dakord te rrisin kapitalin themeltar brenda nje periudhe 1 vjecare nga data e themelimit te saj deri ne shumen 2.520.000.000 Leke(perfshi kapitalin fillestar), nepermjet emetimit te aksioneve te reja, duke ruajtur pjesemarrjen ne kapital ne raportin 80% me 20%. Rritja do te kryhet nepermjet kontributit ne natyre apo para si me poshte:

4



a- Aksionari "Diagnostic and Therapeutic Center of Athens HYGEIA" S.A. do te kontribuojë ne natyre apo para ne shumën prej 1.915.200.000 Leke dhe do te zoterojë 80% te aksioneve te Shoqërisë;

b- Aksionari Shyqyri Duraku do te kontribuojë ne natyre, nepermjet trojeve ku do te ndertohet spitali që do te konsistojë ne 6 prona te rregjistruara ne zonen kadastrale N.2679 me numer pasurie N.66/13, 66/32, 66/33, 66/35, 66/36 dhe 66/37 dhe do te zoterojë 20% te aksioneve te shoqërisë.

**Neni 7**

Themeluesit të cilët nënshkruajnë këtë kontratë, kontribuojnë në kapital me këto shuma:

Aksioneri	Nr. Aksioneve	Pjesmarrja (LEK)
DIAGNOSTIC THERAPEUTIC CENTER OF ATHENS HYGEIA SA	AND 100.800	100.800.000
	25.200	25.200.000
<i>Totali</i>		

**Neni 8**

Statuti i cili i bashkangjitet këtij Akt - Themelimi, përbën pjesë plotësuese të këtij dokumenti dhe konsiderohet pjesë e pandarë e tij.

**Neni 9**

Ky Akt Themelimi hartohet në pesë (5) kopje dhe pasi nënshkruhet me vullnetin e lirë të palëve përpara noterit, depozitohet një kopje në Zyrën e Noterisë, një kopje në Regjistrin Tregtar mbajtur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kopje pranë organeve tatimore dhe dy kopje depozitohen pranë Shoqërisë.

**AKSIONERËT THEMELUES**


1. Qendra Diagnostikuese dhe Terapeutike Athens 2. Shyqyri Duraku  
Hygeia Sh.a

(DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC CENTER OF  
ATHENS HYGEIA SA)

Themistoklis Charanis



Shyqyri Duraku



STATUTI  
I  
SHOQËRISË TREGTARE  
"HYGEIA HOSPITAL - TIRANA" SH.A.



KAPITULLI I  
KRIJIMI-FORMA-KOHËZGJATJA-EMËRTIMI-OBJEKTI-KAPITALI  
THEMELTAR

**Neni 1**

Aksionerët themelues:

1- Qendra diagnostikuese dhe terapeutike Athens Hygeia Sh.a (DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC CENTER OF ATHENS HYGEIA SA), me numer regjistrimi N.13165/06/B/86/14, me seli ne Bulevardi Kifisias & Erithru Stavru 4, 15123 Marusi, Athine, Gereqi, perfaqesuar nepermjet autorizimit te Bordit te Drejtoreve te dates 23.03.2007, Z. Themistoklis Charamis i biri i Vasilit, mbajtes i pasaportes me N. AB2499693

2- Z. Shyqyri Duraku, shtetas shqiptar, banues ne Tirane, Rruga Kavajes N.56, Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes me N. D0000993.

Vendosën krijimin e shoqërisë anonime me emërtimin: "HYGEIA HOSPITAL – TIRANA Sh.A".

**Neni 2**

Vendi i ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë dhe selia e saj ligjore ndodhen në Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1., Tirane, Shqipëri. Me vendim të Asamblesë së Jashetezakonshme të Aksionereve, Shoqëria mund të çelë zyra dhe agjenci si në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj, pas marrjes së miratimit nga shoqëria e regjistruar në Shqipëri.

**Neni 3**

Kohëzgjatja e Shoqërisë përcaktohet në bazë të këtij statuti në 50 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Gjykatë. Shoqëria mund të prishet edhe para se të mbarojë periudha 50 vjeçare ose kohëzgjatja e saj mund të zgjatet mbi 50 vjet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionereve, në bazë të legjislacionit shqiptar.

47

#### Neni 4

Objekt i veprimtarisë së Shoqërisë do të jenë këto aktivitete:



1. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese, dhe, qendrave ambulatorë të diagnostikimit, në territorin e Shqipërisë.
2. Drejtimi i strukturave me qëllim promovimin e kërkimit mjekësor dhe metodat e diagnostikimit dhe kurimit.
3. Organizimi dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorë të kujdesit si konsulent.
4. Organizimi i qendrave të trainimit dhe/ose programeve për edukimin dhe trainimin e doktorëve, infermiereve, dhe personelit administrativ.
5. Zhvillimin e aktivitetit tregtar për importimin dhe/ose eksportimin e mjeteve mjekësore, aparatura dhe pajse, mjeteve farmaceutike, etj.
6. Organizimi i shërbimeve logjistike për materialet (e qëndrueshme dhe delikate) dhe lëndët farmaceutike të përdorura në strukturat e diagnostikimit dhe kurimit dhe qendrat ambulatorë të kujdesit.
7. Dhënia organizatave të tjera, i shërbimit të konsulencës lidhur me të gjitha aspektet e menaxhimit të kujdesit shëndetësor dhe shërbimit të kujdesit ndaj pacientit.

Për ndjekjen dhe arritjen e objektivave të saj, Shoqëria do të:

1. bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo shoqëri tjetër me të njëjtin objekt, që kanë të njëjtat objektiva brenda Shqipërisë ose jashtë saj.
2. çelë degë, filiale, agjensi, ose zyra përfaqësimi Brenda ose jashtë Shqipërisë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. përfaqësojë subjekte ligjore dhe individë, shqiptarë ose të huaj, që kanë objekt të njëjë ose që lidhet me të.

## KAPITULLI II

### Neni 5

#### KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë përcaktohet në shumën 126.000.000 lekë (njqind e njezete e gjashte milion lekë).
2. Kapitali ndahet në 126.000 (njqind e njezet e gjashte mijë) aksione me vlerë nominale 1000 lekë (njemije mijë lekë) secila. Aksionet janë të pandashme.
3. Aksioneret bien dakord te rrisin kapitalin themeltar brenda nje periudhe 1 vjecare nga data e themelimit te saj deri ne shumen 2.520.000.000 Leko(perfshi kapitalin fillestar), nepermjet

+

emetimit të aksioneve të reja, duke ruajtur pjesëmarrjen në kapital në raportin 80% me 20%. Rritja do të kryhet nëpërmjet kontributit në natyrë apo para si më poshtë:

a- Aksionari "Diagnostic and Therapeutic Center of Athens HYGEIA" S.A. do të kontribuojë në natyrë apo para në shumën prej 1.915.200.000 Leke dhe do të zotërojë 80% të aksioneve të Shoqërisë;

b- Aksionari Shyqer Duraku do të kontribuojë në natyrë, nëpërmjet trojeve ku do të ndërtohet spitali që do të konsistojë në 6 prona të regjistruara në zonën kadastrale N.2679 me numër pasurie N.66/13, 66/32, 66/33, 66/35, 66/36 dhe 66/37 dhe do të zotërojë 20% të aksioneve të shoqërisë.

## **NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

### **Neni 6**

#### **ZMADHIMI I KAPITALIT**

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe ndryshimit të Statutit.

Kapitali Themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë.

Në rast se zmadhimi i kapitalit bëhet me kontribut në natyrë, me vendim të gjykatës kompetente, emërohen një ose më shumë ekspertë të cilët do të përcaktojnë vlerën e këtij kontributi, në bazë të nenit 162 dhe kufizimet e nenëve 168, 169 të L. 7638/92.



Në rast se zmadhimi i kapitalit bëhet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja, aksionerët ekzistues të Shoqërisë kanë të drejtë përparësie në nënshkrimin e aksioneve të reja.

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të realizohet brenda 5 (pesë) vjetëve nga dita që Asambleja e Jashtëzakonshme ka miratuar këtë zmadhim (neni 153 L. 7638/92) ose për një periudhë më të shkurtër që mund të vendoset nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve.

### **Neni 7**

#### **ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

Zvogëlimi i kapitalit vendoset vetëm nga Asambleja e Jashtëzakonshme. Në Asambleshën e Përgjithshme që thirret për zvogëlimin e kapitalit dorëzohet raporti i arsyetuar i Drejtorisë duke shpjeguar arsyet që bëjnë të detyrueshëm marrjen e vendimit përkatës. Në të gjitha



rastet zvogëlimi prek aksionerët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zotërojnë, në bazë të nenit 164 të L. 7638/92.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit i komunikohet ekspertit kontabël, të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, që është përgjegjëse për të vendosur mbi këtë projekt, në mënyrë që eksperti kontabël t'i paraqesë Asamblesë mendimin e tij.

**Neni 8**

### **SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT**

Nuk mund të merret vendim dhe të realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para në dorë nëse kapitali ekzistues aksionar nuk është shlyer plotësisht. Në rast të kundërt, operacioni i zmadhimit të kapitalit dhe emetimit të aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm, në bazë të nenit 153 L. 7638/92. Këshilli Mbikqyrës në çdo rast të zmadhimit të kapitalit duhet që në një afat tre (3) muaj nga realizimi i zmadhimit të kapitalit të verifikojë depozitimin e kapitalit. Nëse kapitali nuk është paguar plotësisht, atëherë Këshilli Mbikqyrës disponon lirshëm aksionet e pashlyera tek të tretët, ose kapitali aksionar shtohet deri në shumën e mbulimit të tij.

### **KAPITULLI III**

#### **AKSIONET**

**Neni 9**


Aksionet janë nominative. Për aksionet do të lëshohen tituj të transferueshëm. Tipi i tyre do të vendoset nga Këshilli Mbikqyrës, i cili do të përcaktojë gjithashtu edhe personat që do të nënshkruajnë titujt (çertifikatat e aksioneve). Aksioni u transferohet të tretëve, në bazë të nenit 198 të L. 7638/92. Aksionet janë të pakthyeshme kundrejt Shoqërisë. Në kohën e themelimit të Shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve, mund të krijohen aksione me përparësi që kanë avantazhe në raport me të gjitha aksionet e tjera, sipas nenit 148 & 149 të L. 7638/92.

**Neni 10**

Aksionet janë të pandashme kundrejt Shoqërisë, e cila njih vetëm një pronar kryesor të një aksioni. Çdo aksion jep të drejtën e një vote. Në rastin kur për një aksion ka më shumë se një zotërues, atëherë bashkëpronarët të drejtat e tyre duhet t'i ushtrojnë nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët, në rast të kundërt ushtrimi i të drejtave që i takojnë këtij aksioni do të pezullohen.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm mbajtësi i tij i ligjshëm. Aksionerët nuk janë përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë.

✓



Aksionerët ushtrojnë të drejtat e tyre lidhur me administrimin e Shoqërisë nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

#### Neni 11

Në rast kur cilido aksioner dëshiron të transferojë një pjesë ose të gjitha aksionet e tij, është i detyruar që më përpara të bëjë të njohur me shkrim tek Këshilli Mbikqyrës duke bërë të njohur edhe vlerën e aksioneve me qëllim që aksionerët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për blerjen e këtyre aksioneve. Këshilli Mbikqyrës është i detyruar brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e lajmërimit përkatës të lajmërojë me shkrim të gjithë aksionerët e tjerë. Aksionerët e tjerë kanë për detyrë që brenda afatit njëzet (20) ditor të bëjnë të njohur tek Këshilli Mbikqyrës nëse do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo. Në rast se numri i aksionerëve që interesohen për blerjen e aksioneve është më shumë se një, atëherë secili prej tyre do të blejë aksione në përpjestim me numrin e aksioneve që zotëron aktualisht. Çdo transferim aksionesh tek të tretët do të jetë i vlefshëm vetëm nëse aksionerët nuk ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kjo duke patur parasysh që ndërmjet ofertave me vlerë të njëjtë, oferta e aksionerit ekzistues gëzon përparësi.

Çdo transferim aksionesh që bëhet në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm dhe nuk sjell rezultat të ligjshëm si për aksionerët ashtu edhe për Shoqërinë.

### KAPITULLI IV

#### ORGANET E SHOQËRISË

##### Neni 12

#### DREJTORIA

Drejtoria është organi që përfaqëson Shoqërinë dhe organi kompetent për të vendosur për çdo çështje lidhur me drejtimin e saj, administrimin e pasurisë së saj dhe në përgjithësi me arritjen e qëllimeve të saj brenda objektit të Shoqërisë. Drejtoria nuk ka të drejtë të vendosë për çështje që janë kompetencë e Këshillit Mbikqyrës dhe Asamblesë së Aksionerëve ose bien në kundërshtim me objektin e krijimit të Shoqërisë.

Drejtoria zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës dhe përbëhet nga 6 anëtarë. Drejtoria duhet të raportojë në Këshillin Mbikqyrës çdo muaj.


Anëtarët e parë të Drejtorisë janë:

1- Z. Themistoklis Charamis

2- Znj. Dhurata Duraku

3- Z. Fotios Triantafillias

+





4- Z. Antony Rapp

5- Z. Christos Zilidis

6- Georgios Stathakos

Këshilli Mbikqyrës emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë i cili përfaqëson Shoqërinë.

**Drejtori i parë i Shoqërisë do të jetë:**

- Z. Christos Zilidis

Neni 13

**KËSHILLI MBIKQYRËS**

Përgjegjësia e drejtimit të Shoqërisë i takon Këshillit Mbikqyrës, i cili zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përbëhet nga 3 anëtarë. **Këshilli Mbikqyrës i parë që do të drejtojë Shoqërinë është:**

1- Z. Paschalis Bouchoris

2- Z. Shyqyri Duraku

3- Znj. Areti Souvatzoglou

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme mund të zgjedhë si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës edhe individë të cilët nuk janë aksionerë. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk kanë përgjegjësi personale kundrejt të tretëve dhe kundrejt aksionerëve të Shoqërisë, por kanë përgjegjësi kundrejt personit juridik të Shoqërisë për detyrat që u janë ngarkuar.

Këshilli Mbikqyrës zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e tij. Kryetari kryeson mbledhjet e këshillit dhe në rast se mungon ose i ndalohe të marrë pjesë, zevendësohet nga një nënkryetar.

Neni 15

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës caktohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare e cila mund të shtyhet deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që miraton llogaritë vjetore financiare (rezultatet) dhe që do të mbledhet detyrimisht brenda gjashtë muajit të parë nga mbyllja e llogarive financiare vjetore.

Në rast vdekjeje, shkarkimi nga detyra ose të mungesës të pajustificuar të një anëtari të Këshillit Mbikqyrës nga mbledhjet për më shumë se tre muaj rresht, Këshilli Mbikqyrës

+



mund të zgjedhë zëvendës të tij deri në mbledhjen e parë të Asamblesë së Përgjithshme, që do të ratifikojë zgjedhjen e tij.

Këshilli Mbikqyrës thirret nga Kryetari dhe në rast se ai nuk ka mundësi ose mungon, thirret nga nënkryetari dhe quhet i mbledhur në mënyrë të rregullt në selinë e Shoqërisë ose në Athinë, ose në cilindo qytet të huaj, së paku çdo tre (3) muaj, ose në raste të jashtëzakonshme mbas kërkesës të të paktën dy (2) anëtarëve. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës merren me shumicë absolute votash të të pranishmëve dhe të votave të përfaqësuar. Këshilli Mbikqyrës ka qorum dhe mbledhet ligjërisht kur janë prezent ose përfaqësohen të paktën gjysma plus një e numrit të anëtarëve të tij. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës që mungon mund të përfaqësohet në mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës vetëm nga një anëtar tjetër i këtij Këshilli.

#### **Neni 16**

Për diskutimet që bëhen dhe për vendimet që merren, mbahet procesverbal i cili nënshkruhet nga anëtarët present. Në procesverbal shënohen edhe mendimet e atyre që nuk janë dakort.

Këshilli Mbikqyrës ushtron kontroll ndaj Drejtorisë për administrimin e Shoqërisë nga ana e saj.

Ai ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikimet dhe kontrollet që ai i çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentat që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

Këshilli Mbikqyrës nuk ka të drejtë të marrë vendim për çështje që janë në kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.

Tek anëtarët e Këshillit Mbikqyrës jepet shpërblim, i cili përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 17**

### **KONTROLLI I SHOQËRISË**

Kontrolli (auditimi) i Shoqërisë ushtrohet nga eksperti kontabël i autorizuar që emërohet nga Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve për një periudhë një (1) vjeçare. Përfundimisht, eksperti i parë kontabël përcaktohet në këtë Statut dhe është:

- **Shoqëria Ernst & Young Shqiperi, Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Tirane**

Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ekspert kontabël të autorizuar që ka këto detyra:

1. Ndihmon në mbajtjen e llogarive të Shoqërisë në mënyrë që ato të jenë sipas parimeve bazë të kontabilitetit.

f



2. Përgatit raportin vjetor të llogarive vjetore për tu shqyrtuar nga Drejtoria që përfshijnë bilancin, llogarinë e fitimeve dhe humbjeve, si dhe të dokumentave të tjera që kanë lidhje me to, si dhe shpreh mendimin nëse të dhënat ekonomike reflektojnë realitetin e gjendjes vjetore financiare të Shoqërisë.

3. Informon Këshillin Mbikqyrës në lidhje me ndonjë parregullsi të mundshme që vihet re ose takohet në transaksionet financiare, procedurat, aktivet (asetet) ose llogaritë e Shoqërisë të cilat do të mund t'i sjellin humbje Shoqërisë.

4. Sigurohet që është respektuar barazia ndërmjet aksionerëve.

#### Neni 18

Në rast të mos kryerjes me saktësi të detyrave të tij, eksperti kontabël i autorizuar mund të pezullohet nga detyra e tij me vendim gjyqi i cili mblidhet dhe vendos me procedurë urgjente.

#### Neni 19

Eksperti kontabël i autorizuar ka për detyrë të mbikqyrë bilancin vjetor që duhet të përpilohet në bazë të rregullave ndërkombëtare të pranura të kontabilitetit dhe të shprehin me saktësi rezultatet e veprimtarisë gjatë periudhës së fundit ushtrimore. Eksperti kontabël ka dhe kompetencat që përcaktohen nga nenet 178, 179, 180 dhe 182 të L. 7638/92.

Eksperti kontabël ka mundësi, mbas kërkesës së tij, të ndihmohet në veprimtarinë e tij nga ekspertë të cilët do të emërohen nga Këshilli Mbikqyrës, në bazë të nenit 19 të L. 7560/92.


#### Neni 20

Eksperti kontabël i autorizuar njofton Drejtorinë dhe Këshillin Mbikqyrës për:

1. Kontrollat, verifikimet që kanë kryer dhe sondazhet e ndryshme që kanë bërë;
2. Pjesët e bilancit dhe të dokumentave të tjera të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet të ishin bërë ndryshime, duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorura në përpilimin e këtyre dokumentave;
3. Parregullshmëritë dhe pasaktësitë që kanë zbuluar;
4. Pasojat që vijnë nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar në vijim, krahasuar me ato të vitit të mëparshëm financiar.

#### Neni 21

✓



Për kryerjen e veprimeve dhe për dhënien e shpërblimeve anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, të Drejtorisë dhe të Ekspertit Kontabël, zbatohen nenet 122-127 të L. 7638/92.

#### Neni 22

#### **ASAMBLEJA E AKSIONERËVE**

Asambleja e Aksionerëve është organi më i lartë i Shoqërisë dhe vendos për çdo çështje lidhur me Shoqërinë. Vendimet e Asamblesë së Aksionerëve janë detyruese për aksionerët. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbledhen në mënyrë të rregullt në selinë e Shoqërisë, ose në Athinë, ose në çdo qytet të huaj.

Vetëm Asambleja e Jashtëzakonshme ka të drejtën e ndryshimit të statutit, në lidhje me gjithë dispozitat e tij. Çdo dispozitë tjetër konsiderohet i pavlefshëm.

Asambleja e Jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në rast se të pranishmit ose aksionerët e përfaqësuar përbëjnë të paktën 50 % të kapitalit aksionar, gjatë mbledhjes së saj të parë. Në rast se quorumi i kërkuar nuk arrihet, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të përsëritet një ditë tjetër dhe do të mbahet jo më shumë se dy (2) muaj nga dita e mbledhjes së parë. Në këtë rast, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e rregullt nëse në të janë prezent personalisht ose përfaqësuesit e aksionerëve që përfaqësojnë 1/4 e kapitalit aksionar.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme merren me shumicën e ¾ të votave të të pranishmëve ose të votave të përfaqësuar.

#### Neni 23

#### **ASAMBLEJA E ZAKONSHME**


Asambleja e Zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që referohen në nenin 128 L. 7638/92.

Asambleja e Zakonshme merr vendim në mënyrë vendimtare për të gjitha çështjet thelbësore që kanë të bëjnë me Shoqërinë. Për marrjen e vendimeve të vlefshme në Asamblenë e Zakonshme duhet të jenë prezent ose të përfaqësohet 1/4 e kapitalit aksionar. Në rast të mos arrijtes së quoromit, Asambleja e Zakonshme mund të mbledhet përsëri brenda muajit. Në këtë rast nuk kërkohet quorum. Vendimet e Asamblesë së Zakonshme merren me shumicë absolute të votave prezente ose të përfaqësuar.

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme mbledhet sëpaku një herë në vit ose brenda gjashtë muajorit mbas mbarimit të vitit financiar.

Ky afat mund të shtyhet me vendim gjyqi. Asambleja shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet e vitit financiar që u mbyll. Ajo ushtron kompetencat që ka në bazë të neneve 105,

Y



108, 109, 123 dhe parag 3 i nenit 125 të L. 7638/92.

#### Neni 24

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Drejtoria. Në mungesë të tyre mund të thirret gjithashtu nga:

1. Këshilli Mbikqyrës ose nga ekspertët kontabël të autorizuar.
2. Nga personi i autorizuar nga gjykata mbas kërkesës të çdo të interesuari për një rast urgjent ose të një ose disa aksionerëve që të gjithë bashkë zotërojnë 1/10 e kapitalit.
3. Nga likuidatorët.

Mbledhja e Asamblesë të Aksionerëve realizohet ashtu siç përcaktohet nga ligji në ambjentet e Shoqërisë ose në Athinë, Greqi, ose në ndonjë qytet tjetër të huaj.

#### Neni 25

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme duke caktuar gjithashtu çështjet e rendit të ditës bëhet ashtu siç përcaktohet nga ligji. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme edhe në rastin kur nuk janë zbatuar procedurat e thirrjes së përcaktuar nga ligji, nëse në Asamblenë e Përgjithshme janë prezent ose përfaqësohen të gjithë aksionerët që zotërojnë kapitalin aksioner të Shoqërisë dhe kur asnjëri prej tyre nuk ngre ndonjë kundërshtim. Rendi i ditës i Asamblesë së Aksionerëve përcaktohet nga organi që thërret Asamblenë e Përgjithshme. Rendi i ditës së Asamblesë nuk mund të ndryshohet me lajmërim të dytë.

#### Neni 26

Çdo aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga e shoqja / i shoqi.

#### Neni 27

Drejtoria është e detyruar të vendosë në dispozicion të aksionerëve para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dokumentacionin që përcaktohet nga neni 136 i ligjit 7638/92, sipas procedurës që përshkruhet në këtë nen.


#### Neni 28

Aksionerët që duan të marrin pjesë në Asamble duhet të depozitojnë aksionet e tyre në bankë ose në ambjentet e Shoqërisë, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ligji.

#### Neni 29

Në rast se një aksion i takon më shumë se një personi, ata janë të detyruar të caktojnë një përfaqësues të përbashkët i cili do të ushtrojë të drejtat e tyre që rrjedhin nga ky aksion.

*f*



**Neni 30**

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, anëtarët e drejtorisë dhe ekspertët kontabël të autorizuar mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme me vota konsultative. Ata kanë votë vendimore kur kanë cilësinë e aksionerit.

**Neni 31**

Emrat e atyre që marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme shënohen në "Librin e Pjesëmarrjes".

Ecunia e mbledhjeve regjistrohet në procesverbal.

**Neni 32**

Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose, në mungesë të tij, nga Nën-Kryetari i Këshillit ose nga një prej anëtarëve më të vjetër të pranishëm. Detyrat e sekretarit i kryen personi që caktohet nga Kryetari.

**Neni 33**

Duke filluar që nga momenti i lajmërimit të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme vjetore, çdo aksioner ose përfaqësuesi i tij që do ta përfaqësojë në asamble, ka të drejtë që në selinë e Shoqërisë të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen në nenin 143 L. 7638/92 dhe veçanërisht për:


- Inventarin, bilancin vjetor, listën e anëtarëve të Drejtorisë si dhe listën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.
- Raportet e Drejtorisë, të Këshillit Mbikqyrës dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- Shumën e saktë të shpërblimit që marrin personat e mësipërm.

**Neni 34**

Çdo aksioner ka të drejtë të informohet ose të marrë kopje të listës së aksionerëve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë më parë se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 35**





Në rast të refuzimit të pjesshëm ose të plotë nga ana e Shoqërisë të të drejtës së aksionerit për t'u informuar mbi dokumentat e sipërpërmendur, aksioneri që mendon se ky qëndrim shkel të drejtat e tij ka ta kundërshtojë atë në gjykatë.

#### Neni 36

### **TË DREJTAT E PAKICËS**

Aksionerët të cilët përfaqësojnë një të dhjetën (1/10) e kapitalit kanë mundësi t'i kërkojnë Këshillit Mbikqyrës të thërrasë Asambleshën e Jashtëzakonshme duke përcaktuar dhe çështjet e rendit të ditës. Këshilli Mbikqyrës është i detyruar të thërrasë Asambleshën e Përgjithshme të kërkuar, përveç rastit kur ka arsye shumë të fortë për të mos e mbledhur. Në këtë rast, Këshilli mund ta kundërshtojë thirrjen e mbledhjes. Aksionerët që përbëjnë një të dhjetën e kapitalit aksioner mund ta kundërshtojnë këtë vendim në gjykatë dhe të kërkojnë verifikimin e ekzistencës të shkakut të fortë dhe thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme me vendim gjyqi.

Me kërkesë të aksionerëve që përfaqësojnë një të dhjetën (1/10) e kapitalit aksioner, Kryetari i Asamblesë ka mundësi të shtyjë për një herë të vetme marrjen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme ose të Jashtëzakonshme, duke përcaktuar njëkohësisht dhe ditën e mbledhjes për marrjen e vendimit, ditë e cila nuk mund të caktohet më vonë se 30 ditë pas nga dita e mbledhjes së parë.

### **KAPITULLI VI**

#### Neni 37

Shoqëria mban në zyrat e saj librat që kërkohen nga ligji dhe ku përfshihen llogaritë vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet financiare vjetore dhe çdo e dhënë tjetër që parashikohet nga ligji.

#### Neni 38

Viti financiar ka kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor të çdo viti. Përfshihet viti i parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në gjykatë dhe mbaron më 31.12.2007.


Në fund të çdo viti financiar, Drejtorja bën inventarin dhe llogaritë vjetore në bazë të dispozitave të ligjeve në fuqi, si dhe përpilon raportin për administrimin e Shoqërisë.

#### Neni 39

### **REZERVAT E DOMOSDOSHME**

Rezerva do të krijohet nëpërmjet zbritjes çdo vit të një përqindje nga fitimi. Kjo rezervë do të krijohet nga mbajtja e të paktën 5 % nga fitimi vjetor neto i Shoqërisë pas zbritjes së

+



humbjeve të mbartura të viteve të mëparshme nëse ka. Kjo procedurë pushon së qeni e detyrueshme kur shuma e rezervës arrin vlerën e barabartë me 1/10 e kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 40**

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimet që do të ndahen janë fitimet e vitit financiar në fjalë pasi të jenë zbritur shuma e reserves së detyrueshme dhe shuma e humbjeve të viteve të mëparshëm fiskalë, sipas nenit të mësipërm.

**Neni 41**

**PËRCAKTIMI I DIVIDENTËVE**

Mbas miratimit të bilancit vjetor dhe përcaktimit të shumës së fitimit që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme cakton shumën që do të ndahet tek aksionerët në formën e dividendëve, në bazë të neneve 215, 216 të L. 7638/92.

**KAPITULLI V**

**Neni 42**

**PRISHJA**

Shoqëria priset nëse ka mbaruar kohëzgjatja e saj ose në qoftë se ka shpallur falimentimin.

**Neni 43**

**LIKUIDIMI**

Me prishjen e Shoqërisë fillojnë procedurat e likuidimit të cilat zhvillohen sipas dispozitave që përcaktohen nga ligji.


Shoqëria hyn në likuidimin, me prishjen së saj për çdo lloj arsye, kjo me përjashtim të rastit të nenit 10 të L. 7638/92. Në emërtimin e Shoqërisë, gjatë gjithë periudhës së likuidimit, duhet të përfshihet edhe shprehja "shoqëri në likuidim". Kjo shtesë, si dhe emri i likuidatorit duhet të shënohen në të gjitha aktet dhe dokumentat që lëshon Shoqëria tek të tretët.

**KAPITULLI VI**

**Neni 44**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**







Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut dhe në aktin e themelimit të Shoqërisë zbatohen dispozitat në fuqi të ligjit për shoqëritë anonime pa ofertë publike.

## KAPITULLI VII

### Neni 45

#### DISPOZITAT E FUNDIT

#### MBULIMI I KAPITALIT AKSIONER

Kapitali Aksioner mbulohet si më poshtë:

Emri	Nr. i aksioneve	Pjesmarrja (Lek)	Përqindja (%)
Diagnostic and Therapeutic Center of Athens Hygeia S.A.	and 100.800	100.800.000	80%
Shyqyri Duraku	25.200	25.200.000	20%

### Neni 46


Emertimi i Shoqërisë caktohet "HYGEIA HOSPITAL - TIRANA SH.A" i cili përbahet edhe në vulën e saj sipas nenit 57 L. 7560/92.

### Neni 47

Ky statut hartohet në pesë (5) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi nënshkruhet me vullnetin e lirë të palëve përpara noterit, depozitohet një kopje në Zyrën e Noterisë, një kopje në Regjistrin Tregtar mbajtur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kopje pranë organeve tatimore dhe dy kopje depozitohen pranë Shoqërisë.

#### AKSIONERËT THEMELUES

1. Qendra diagnostikuese dhe terapeutike 2. Z. Shyqyri Duraku  
Athens Hygeia Sh.a  
(DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC CENTER OF  
ATHENS HYGEIA SA)  
Themistoklis Charamis



Shyqyri Duraku  
